

---

## THE IMPACT OF COVID-19 ON SMALL BUSINESS - THE CASE OF SMALL ENTERPRISES IN SOME COUNTRIES OF THE WORLD

**Merita Bakiji**

South East European University, N. Macedonia, mb22289@seeu.edu.mk

**Abstract:** Small manufacturing businesses as well as small businesses in the service sector have always been typical economic entities of market economies in every country of the world. They make a great contribution to job creation, especially through self-employment. So small business offers more employment opportunities than big business. This means that they significantly affect the reduction of the unemployment rate through the contribution to the overall development of the economy. So, small business is considered as the driving force of economic development, therefore any shock to the economy caused by various factors, directly affects the activity and activity of any small business.

The global economy is continuing to suffer the consequences of the major shock caused by the coronavirus pandemic. The crisis caused by COVID-19 has affected many sectors, but from the data we have, in reality the most affected sectors are tourism and other related services, but also the manufacturing and export industries. This is caused as a result of numerous restrictions between different countries of the world. The impact on the economy has been serious enough due to restrictions on movement which have led to a reduction in demand but also supply as a result of limited labor supply and due to difficulties in securing raw materials. The largest percentage of firms in each country were forced to close their business activity, while the rest that continued to remain open have experienced significant declines. So, most businesses have suffered significant revenue losses due to the COVID-19 crisis. Various data and analyzes have shown that small business is more and more severely affected than large business. Total closure for a long period has resulted in a huge loss and fears that a second wave of closure could be fatal for small business. Larger layoffs are observed in small enterprises due to their inability to keep their employees in the workplace. In addition to this concern, the concern of the manufacturing sector is the loss of production capacity.

Understanding the importance and value of small business in the economy as a whole, this research aims to gather evidence regarding the possible effects of the COVID-19 pandemic on business and its activity as well as to reveal the negative effects as a result of the shock caused by the recent global economic crisis. This study was undertaken to obtain a concise overview of the impact of the COVID-19 pandemic on small enterprises in several countries of the world used as valuable examples to clarify the negative impact on these businesses.

**Keywords:** Small business, COVID-19, global economy, economic downturn, negative effects

## NDIKIMI I COVID-19 NË BIZNESIN E VOGËL-RASTI I NDËRMARRJEVE TË VOGLA NË DISA VENDE TË BOTËS

**Merita Bakiji**

South East European University, N. Macedonia, mb22289@seeu.edu.mk

**Abstrakti:** Bizneset e vogla prodhuese si dhe bizneset e vogla në sektorin e shërbimeve, gjithmonë kanë qenë subjekte tipike ekonomike të ekonomive të tregut në çdo vend të botës. Ato ofrojnë kontribut të madh në hapjen e vendeve të punës, veçanërisht përmes mënyrës së vetëpunësimit. Pra, biznesi i vogël ofron mundësi punësimit më tepër se biznesi i madh. Kjo nënkupton që ato vlefshëm ndikojnë në zvogëlimin e nivelit të papunësisë përmes kontributit në zhvillimin e tërësishëm të ekonomisë. Pra, biznesi i vogël llogaritet si forca lëvizëse e zhvillimit ekonomik, andaj çdo goditje në ekonomi e shkaktuar nga faktorë të ndryshëm, ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë mbi aktivitetin dhe veprimtarinë e çdo biznesi të vogël.

Ekonomia globale po vazhdon të vuajë pasojat e goditjes së madhe të shkaktuar nga pandemia e koronavirusit. Kriza e shkaktuar nga COVID-19 ka prekur shumë sektorë, por nga të dhënat që posedojmë, realisht sektorët më të prekur janë turizmi dhe shërbimet e tjera të lidhur me të, por gjithsesi edhe industria e prodhimit dhe eksporti. Kjo është shkaktuar si rezultat i kufizimeve të shumta mes vendeve të ndryshme të botës. Ndikimi në ekonomi ka qenë mjaftueshëm serioz për shkak të kufizimeve në lëvizje të cilat kanë çuar në zvogëlim të kërkesës por edhe të ofertës si rezultat i ofertës së limituar të punës si dhe për shkak të vështirësive në sigurimin e lëndëve të para. Përqindja më e madhe e firmave në secilin vend u detyruan të mbyllnin aktivitetin e tyre biznesor, ndërsa pjesa tjetër që vazhduan të qëndrojnë hapur kanë përjetuar rënie të ndjeshme. Pra, numri më i madh i bizneseve kanë pësuar humbje të

koniderueshme të të ardhurave për shkak të krizës së COVID-19. Nga të dhënat dhe analizat e ndryshme ka rezultuar që biznesi i vogël është më tepër dhe më rëndë i prekur se biznesi i madh. Mbyllja totale për një periudhë të gjatë ka rezultuar me një humbje të madhe dhe frikë se një valë e dytë e mbylljes mund të jetë fatale për biznesin e vogël. Largimet më të mëdha nga puna observohen te ndërmarrjet e vogla për shkak të mosaftësisë së tyre për t'i mbajtur në vendin e punës punëtorët e vet. Përveç këtij shqetësimi, brenga e sektorit të prodhimit është humbja e kapaciteteve prodhuese.

Duke kuptuar rëndësinë dhe vlefshmërinë e biznesit të vogël në ekonominë në tërësi, ky hulumtim synon të mblledh evidenca në lidhje me efektet e mundshme të pandemisë COVID-19 mbi biznesin dhe aktivitetin e tij si dhe të shpalos efektet negative si pasojë e goditjes të shkaktuar nga kriza e fundit globale ekonomike. Ky studim është ndërmarrë për të fituar një pasqyrë të përmbledhur të ndikimit të pandemisë COVID-19 në ndërmarrjet e vogla në disa vende të botës të shfrytëzuara si shembuj të vlefshëm për të qartësuar ndikimin negativ mbi këto biznese.

**Fjalët kyçe:** Biznesi i vogël, COVID-19, ekonomia globale, rënie ekonomike, efekte negative

## 1. HYRJJE

Në përgjithësi, dokumenti ynë kontribuon në kuptimin e ndikimit ekonomik të COVID-19 në ekosistemin e biznesit të vogël. Që nga paraqitja dhe shpërthimi i pandemisë, gati çdo biznes në botë është prekur nga COVID-19. Pandemia e shkaktuar nga koronavirusi 2019 (COVID-19), ka shkaktuar një tronditje të madhe ekonomike në mbarë botën. Ajo po ndryshon në mënyrë dramatike jetën tonë. Për shkak të pandemisë, shumë kompani për herë të parë u përballën me sfida unike dhe të panjohura. Kufizimi i veprimtarive të biznesit, distancimi social dhe masat e tjera që ndërmorrën qeveritë e ndryshme, krijuan disa sfida jo të zakonshme për bizneset. Ato u përballën me rrënie e numrit të klientëve, mungesë likuiditeti, probleme me pagesën e pagave dhe tatimeve si dhe me pasiguri ligjore. Përveç kësaj, ndërmarrjet duhej të adaptoheshin me kushtet dhe mjedisin e ri të krijuar si rezultat i masave që ndërmorrën qeveritë përkatëse. Ky ndikim i COVID-19 në bizneset e vogla në të gjithë botën ka të ngjarë të jetë i fortë dhe me pasoja të rënda për ekonominë në vazhdimësi. Si pasojë e krizës së krijuar nga COVID-19 masat qeveritare të shumë vendeve të botës u miratuan për të përballuar situatën dhe për t'i dhënë një shtysë ekonomisë e cila u pasua nga mbyllje biznesesh dhe papunësi e theksuar.

## 2. NDIKIMI I COVID-19 NË BIZNESIN E VOGËL-RASTI I NDËRMARRJEVE TË VOGLA NË DISA VENDE TË BOTËS

Në lidhje me ndikimin që ka COVID-19 në ekonominë globale thuhet se shpërthimi i Coronavirus mund të quhet krizë ekonomike pasi mund të ketë një efekt të tmerrshëm në ekonominë globale siç pati edhe shpërthimi i mëparshëm i SARS-it (Ahani, Ali; Nilashi, Mehrbakhsh, 2020). Duke marrë parasysh rolin e rëndësishëm që luajnë bizneset për krijimin e vendeve të punës, sigurimin e vetëpunësimit, përmirësimin e statusit ekonomik të zonës rurale si dhe rritjen ekonomike, zhvillimin dhe përparimin në përgjithësi (Bakiji, 2021, p. 300), efektet negative pikërisht i kanë goditur bizneset të cilat kanë qenë pika kritike ku ka gjetur hapësirë për të shpërthyer korona virusi. Në këtë kohë, punëdhënësit janë përballur me sfidën e vështirë për të ruajtur bizneset e tyre përballë rënies ekonomike, ndërkohë që kujdesen edhe për mbajtjen në punë dhe mirëqenien e punonjësve të tyre.

Një hulumtim i bërë shqyrton ndikimin e COVID-19 në peizazhin e biznesit të vogël në Shtetet e Bashkuara, ku mes rezultateve të tjera nxjerr në përfundim se pandemia kishte shkaktuar zhvendosje masive midis bizneseve të vogla vetëm disa javë pas fillimit të saj dhe në të gjithë mostrën e plotë, 43% e bizneseve ishin mbyllur përkohësisht dhe gati të gjitha këto mbyllje ishin për shkak të COVID-19. Mesatarisht, bizneset kishin raportuar ulje të punësimit të tyre aktiv me 39% që nga Janari (Bartik, Alexander W.; Bertrand, Marianne; Cullen, Zoe; Glaeser, Edward L.; Luca, Michael; Stanton, Christopher, 2020).

Po ashtu, një studim tjetër ofron vlerësimet e para të efekteve të COVID-19 në fazën e hershme ku numri i pronarëve të bizneseve që punojnë ranë nga 15.0 milion në Shkurt 2020 në 11.7 milion në Prill 2020 për shkak të COVID-19. Kjo humbje e 3.3 milion pronarëve të bizneseve (ose 22 përqind) ishte rënia më e madhe e regjistruar (Fairlie, The impact of COVID-19 on small business owners: Evidence from the first three months after widespread social-distancing restrictions, 2020).

Studimet e bëra në Iran tregojnë se firmat e reja vuajtën më shumë në muajt e parë të pandemisë. Disa prej tyre morën shkurtime paraprake, disa të tjera ngrinë aktivitetet e tyre dhe madje disa ndaluan shërbimet e tyre. Sipas të dhënave të botuara nga Qendra Statistikore e Studimit dhe Trajnimit të Iranit, tridhjetë e tetë përqind e firmave iraniane ishin joaktive për të paktën dy muaj në gjashtë muajt e fundit (Salamzadeh, Aidin; Dana, Leo Paul, 2020). Shumica e industrive kryesore u përballën me rënie të mëdha të numrit të pronarëve aktivë të bizneseve në Prill, me përjashtimin e vetëm në bujqësi. Ndërtimi, restorantet, hotelet, transporti dhe shërbimet personale / lavanderi të gjitha u përballën me rënie të mëdha në numrin e pronarëve aktivë të biznesit për shkak të COVID-19 (Fairlie, The

impact of COVID-19 on small business owners: Evidence from the first three months after widespread social distancing restrictions, 2020).

Sipas Bankës Botërore, pandemia COVID-19 ka zhytur ekonominë e Ballkanit Perëndimor në një recesion të thellë, si në pjesën tjetër të botës. Në vitin 2020, aktiviteti ekonomik u tkurr me rreth 3.4 përqind - rënia më e keqe e regjistruar. Të dhënat tregojnë se të paktën 50 përqind e firmave në sektorët më të prekur nga kriza në secilin prej vendeve u detyruan të ndërprisnin aktivitetin, ndërsa ato që vijuan të qëndrojnë hapur përjetuan rënie të ndryshme të tij<sup>43</sup> (The Economic and Social Impact of COVID-19, 2020, p. 1).

Sipas të dhënave të Entit Shtetëror të Statistikave të Republikës së Maqedonisë së Veriut, është regjistruar ulje e numrit të subjekteve afariste edhe atë në vitin 2020 numri i subjekteve afariste është 73.061 dhe krahasuar me vitin 2019 është ulur me 3.8%<sup>44</sup> (Kpcreba, 2021). Sipas anketës së Institutit Finance Think, rreth 41.5 përqind e bizneseve u detyruan të mbyllin aktivitetin për shkak të masave kufizuese dhe 43.1 përqind kishin pritshmëri për një rënie të konsiderueshme të të ardhurave<sup>45</sup> (The Economic and Social Impact of COVID-19, 2020, p. 9).

Për shkak se turizmi paraqet një nga sektorët që siguron jetesë për miliona njerëz në mbarë botën, si në vendet e zhvilluara, ashtu edhe në ato në zhvillim, ndërmarrjet e sektorit të turizmit preken më së tepërmi nga pandemia Covid-19, duke prekur në këtë mënyrë ekonominë, mirëqenien, shërbimet publike dhe mundësitë e ndryshme në të gjitha vendet. Kjo ndodh sepse industria e turizmit është thelbësore për shumë punë dhe aktivitete biznesore.

Kështu, për shembull, brenda sektorit të turizmit në Karaibe, sidomos industria e lundrimit është goditur tepër rëndë. Nga 2010 në 2018, ky sektor po rritej mesatarisht me 7.8% në vit. Përderisa në vitin 2019, Karaibet mirëpritën 38% të totalit global të pasagjerëve të anijeve turistike dhe 34% të vendosjes totale të anijeve të lundrimit, megjithatë ndërsa me përhapjen e pandemisë, numri i pasagjerëve kishte rënë në pothuajse zero nga mesi i Marsit 2020 (Mulder, 2020, p. 15). Përveç kësaj, sipas një studimi të OECD mbi ekonominë e vendeve që janë më të varura nga turizmi, ekzistojnë pesë vende evropiane në rrezik më të madh si Greqia, Portugalia, Austria, Spanja dhe Italia, të cilat do të humbin një pjesë të konsiderueshme të PBB-së së tyre, gjë që do të ketë pasoja të këqija ekonomike dhe sociale (Gajić & Cvijanović, 2021, p. 26).

Nga prova të tjera të disponueshme, ne e dimë se bizneset e vogla në përgjithësi janë goditur shumë më rëndë nga kriza sesa bizneset e mëdha dhe kjo ndoshta sepse bizneset e mëdha hynë në krizë me një shëndet më të mirë financiar, kanë qasje më të lehtë në financimin e emergjencave dhe programet e huasë qeveritare, ose përdorin një model biznesi që është më i adaptueshëm ndaj mjedisit të ri ekonomik (Kurman, André; Lalé, Etienne; Ta, Lien, 2020, p. 8).

Ky 'normalitet i ri' i krijuar si rezultat i pandemisë, kërkon një ndryshim në strategjitë e biznesit, në operacionet dhe në sjelljen e biznesit. Bizneset e vogla duhet të kërkojnë mundësi për të rikrijuar veten e tyre dhe të zhvillojnë strategji të reja biznesi që janë thelbësore për të mposhtur sfidat unike me të cilat përballet mbijetesa e tyre (Akpan, Ikpe Justice; Paul, Elijah Abasifreke; Adebisi, Bamidele, 2020).

Për të tejkaluar pasojat e pandemisë, një pjesë e madhe e bizneseve është dashur të ndryshojnë operacionet dhe strategjitë e tyre të biznesit duke u përshtatur me kushtet e reja të vendosura nga qeveria për të siguruar vazhdimësinë e aktiviteteve të tyre biznesore.

Organizatat mund t'i përgjigjen një krize në mënyra të ndryshme nga një ristrukturim i praktikave të biznesit në një reduktim të prodhimit. Mënyra se si një organizatë përgjigjet do të përcaktojë aftësinë e tyre për të pasur një model të qëndrueshëm biznesi që mbijeton në treg. Kjo është e rëndësishme në ndërtimin e rezistencës, por edhe përpjekjen për të anashkaluar pengesat mjedisore (Ratten, 2020).

Ndërmarrjeve të vogla u nevojitet një periudhë e mjaftueshme për të rikuperuar plotësisht operacionet e tyre, madje shumica e ndërmarrjeve vazhdojnë të jenë skeptikë në raport me kthimin në normalitetin e mëparshëm. Një pjesë e tyre parashikojnë një kohë më të gjatë që përpjekjet e tyre për rimëkëmbje të arrijnë rezultatin e dëshiruar ose të mos arrijnë fare një rezultat të pritur.

### 3. KONKLUZION

Covid-19 ka ndryshuar rrënjësisht mënyrën e të punuarit dhe të vepruarit të shumë kompanive në mbarë botën. Shumë ndërmarrje nuk dinin si të reagonin për të adresuar problemet me punëtorët. Pjesa më e madhe e tyre zgjodhën mënyrën e pushimit të punëtorëve nga puna, një pjesë tjetër e mbyllën veprimtarinë e tyre biznesore, ndërsa një pjesë e vogël patën mundësi të vazhdojnë me punën e tyre por me një mënyrë të ndryshme të të vepruarit.

<sup>43</sup> <https://pubdocs.worldbank.org/en/521201591706501992/WBRER-Firm-note-ALB.pdf>

<sup>44</sup> [https://www.stat.gov.mk/pdf/2021/6.1.21.15\\_mk.pdf](https://www.stat.gov.mk/pdf/2021/6.1.21.15_mk.pdf)

<sup>45</sup> <http://documents1.worldbank.org/curated/en/444031591289647448/pdf/The-Economic-and-Social-Impact-of-COVID-19-Private-Sector.pdf>

Ato që vazhduan me të bërit biznes u bazuan ose në të ardhurat e akumuluar, ose duke reduktuar shpenzimet ose duke u mbështetur në kreditë bankare.

Sipas analizave të ndryshme, raportohet se COVID-19 ka pasur një ndikim të thellë sidomos në sektorin privat, përmes disa kanaleve. Ajo që u konstatua është fakti se firmat kanë përjetuar rënie të kërkesës për produktet e tyre, vështirësi në qasjen e financave dhe burimeve, dhe ende vazhdojnë të përballen me një periudhë pasigurie.

Qeveritë e vendeve të ndryshme prezentuan dhe ndërmorrën masa të ndryshme me qëllim që të mos lejojnë kolapsin e ekonomisë. Ndihtmat financiare nga ana e shtetit si për bizneset dhe për të punësuarit dhe të papunësuarit sipas disa bizneseve nuk janë të mjaftushme. Ne propozojmë që të merren parasysh edhe rekomandimet që vijnë nga bizneset, të cilat duhen konsideruar për t'iu mundësuar ndërmarrjeve, punëtorëve dhe familjeve të tyre të përballen me sfidat dhe pasojat që vijnë nga COVID-19.

## REFERENCAT

- Ahani, A., & Nilashi, M. (2020). Coronavirus Outbreak and its Impacts on Global Economy: The Role of Social Network Sites, *Journal of Soft Computing and Decision Support Systems* 7(2): 19-22.
- Bartik, A. W., Bertrand, M., Cullen, Z., Glaeser, E. L., Luca, M., & Stanton, C. (2020). The impact of COVID-19 on small business outcomes and expectations, *Proceedings of the National Academy of Sciences* 117 (30) 17656-17666; DOI: 10.1073/pnas.2006991117.
- Bakiji, M. (2021). ENTREPRENEURSHIP AND THE ROLE OF WOMEN ENTREPRENEURSHIP IN ECONOMIC GROWTH. *Knowledge International Journal*, 45(1), 299-302.
- Fairlie, R. (2020). The impact of COVID-19 on small business owners: Evidence from the first three months after widespread social-distancing restrictions. *J Econ Manage Strat.* 29: 727-740  
<https://doi.org/10.1111/jems.12400>
- Gajić, T., & Cvijanovi ć, D. (2021). IMMEDIATE AND LONG-TERM NEGATIVE IMPACTS OF COVID-19 ON TOURISM. *Knowledge Journal*, 45(1), 25-31. Retrieved from  
<https://ikm.mk/ojs/index.php/KIJ/article/view/4943>
- Ikpe, J. A., Elijah, A.P. & Bamidele, A. (2020). Small business awareness and adoption of state-of-the-art technologies in emerging and developing markets, and lessons from the COVID-19 pandemic, *Journal of Small Business & Entrepreneurship*, DOI: 10.1080/08276331.2020.1820185.
- Kurmann, A., & Lalé, L.T. (2020). The impact of COVID-19 on small business employment and hours: real-time estimates with homebase data. ESG UQAM, Département des science économiques, École des sciences de la gestion, Université du Québec à Montréal.
- Mulder N. (coord.), “The impact of the COVID-19 pandemic on the tourism sector in Latin America and the Caribbean, and options for a sustainable and resilient recovery”, *International Trade series*, No. 157 (LC/TS. 2020/147), Santiago, Economic Commission for Latin America and the Caribbean (ECLAC), 2020.
- Ratten, V. (2020). Coronavirus (covid-19) and entrepreneurship: changing life and work landscape, *Journal of Small Business & Entrepreneurship*, 32:5, 503-516, DOI: 10.1080/08276331.2020.1790167.
- Salamzadeh, A., & Dana, L. P. (2020). The coronavirus (COVID-19) pandemic: challenges among Iranian startups, *Journal of Small Business & Entrepreneurship*, DOI: 10/1080/08276331.2020.1821158.  
<https://pubdocs.worldbank.org/en/521201591706501992/WBRER-Firm-note-ALB.pdf>  
[https://www.stat.gov.mk/pdf/2021/6.1.21.15\\_mk.pdf](https://www.stat.gov.mk/pdf/2021/6.1.21.15_mk.pdf)  
<http://documents1.worldbank.org/curated/en/444031591289647448/pdf/The-Economic-and-Social-Impact-of-COVID-19-Private-Sector.pdf>